



Permbledhje joteknike e aktiviteteteve per Leje Mjedisore

“Veprimtaritë e lëndës së drurit, ID 7.10 b. Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.”



Subjekti: “Rover 08” sh.p.k.

Hartoi: “EKO STUDIO PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2024



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

”Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi te zhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Shoqeria "Rover 08" sh.p.k. është i regjistruar pranë QKB-se me NIPT K82524401F dhe me vendndodhje kryesore Fshati Mbrostar Ura, Pranë Mullirit të Arte, Komuna Mbrostar Ura Fier dhe do të ushtroje aktivitetin "Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit". Aktiviteti do të zhvillohet në adresën "Sheq i madh", Fier.

Subjekti, sipas certifikates së regjistrimit të pronësive, me kod unik 3981008051, do të ketë në përdorim pronësinë në Zonën Kadastrale Nr. 3981, Nr. Pasurie 29/2, me sipërfaqe totale 4585 m² me adresë "Sheq i madh", Fier.



Koordinata e vendndodhjes së aktivitetit në sistemin Ghauss Kruger

	GK	
	X	Y
1	4381745.18	4512690.75



Ne vendndodhjen Zona Kadastrale Nr. 3981, Nr. Pasurie 29/2, me adresen “Sheq i madh”, Fier, operatori nepermjet procedures se lejes se ndertimit ka kryer ndertimin e nje sere bujqesore, pa themele te vazhduara.

Ne vendndodhjen e sipercituar subjekti do te zhvilloje procesin e tharjes se bersive te ullirit te cilat do te sigurohen nga operatore te ndryshem ne varesi te kerkeses. Procesi i tharjes se bersive te ullirit do te konsistoje ne etapat si me poshte:

- 1- Shkarkimi i bersive te ullirit ne vendin e percaktuar nga drejtuesit ne brendesi te perimetrit te pasurise qe do te perdoret per zhvillimin e ketij aktiviteti.
- 2- Shperndarja ne menyre te njetrajtshme te bersive te ullirit ne te gjithes siperfaqen e seres se ndertuar ne funksion te ketij aktiviteti.
- 3- Tharja e bersive realizohet ne menyre natyrale pa patur nevojten e perdorimit te ventilatereve thares apo te ndonje instalimi pasi sic tham tharja realizohet ne menyre natyrale.
- 4- Pasi arrihet tharja e bersive pas nje periudhe te pacaktuar, realizohet mbledhja e tyre dhe depozitimi drejt subjekteve te interesuara per furnizimin me bersi ulliri te thare si lende alternative per djegie ne furra apo si lende ndihmese ne procese te ndryshme, ne varesi te kerkeses.

Per zhvillimin e kesaj veprimtarie mendohet te arrihet nje kapacitet prej 1000-1200 ton/vit bersi.

Lendet e para

Lendet e para ne kete aktivitet jane vetem bersite e ullirit.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Gjeologjia e rajonit

Ne kete rajon kemi te bejm me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfere me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrjedhje te ujervae te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne bazamentin ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuarternar Q₄AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.



Klima

Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngricat dhe dëbora janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund të tetorit. Klima e Fierit është e ngrohtë sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Vera në Fier është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagesht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën që klima të jetë e butë dhe vetëm në raste tepër të rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 15°C-16°C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu tokat bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë në vit. Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klimë mesdhetare fushore. Temperatura mesatare me e larte eshte ne muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e uleta ne muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit. Vlerat me te larta te lageshtise jane ne periudhen e ftohte te vitit ndersa me te uleta ne periudhen e ngrohte te tij. Per arsye se jemi prane zones fushore dhe ne afersi te detit mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit dhe veri perendimit. Ne dimer mbizoterojne erera te lindjes dhe te jugut.

Trashegimia arkitektonike

Aktiviteti që kryhet nuk prek zonat turistike, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte të trashëguara dhe të ndertuara nga njeriu me rëndësi historike, sepse në këto zone ato nuk ekzistojnë. Është për t'u theksuar se në këto zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomomente.

Flora dhe fauna

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos në pjesët bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje të ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa në ujërat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të pyjeve mesdhetare. Shkurret përbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim të perhershëm si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Në këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure të lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, që në disa raste formojnë pyje të vegjel.



✚ Pasurite ujore

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica. Semani - 281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin në afërsi të Beratit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin në 96 m³/sek. Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjosa - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit në Greqi. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6700 km², ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km². Është një nga lumenjtë më të ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rëndësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për tu zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni të kryer.

Ndikime të rëndësishme gjatë funksionimit

Shkarkime në uje

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk do të gjenerohet uje pasi nuk do të ketë përdorim të ujit në aktivitet, gjithashtu nuk do të ketë shkarkime në kanalizime pasi nuk do të ketë gjenerim të ujrave sanitare.

Emetimet në ajer

Gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të kemi emetime të lehta në ajer në mjediset e jashtme. Ky emetim do të vijë si pasojë e clirimit të gazeve dhe të grimcave të pluhurit nga levizja e automjeteve të transportit të lendeve të para dhe të marrjes së lëndës perfundimtare. Në mjediset e brendshme do të ketë prezencë të paket aromash, i cili do të jetë i perhershëm për sa kohë është aktiviteti në funksionim.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat dhe vibrimet do të jenë prezent vetëm gjatë levizjes së automjeteve të automjeteve të transportit të lendeve të para. Këto emetime nuk përbejnë bezdi të banoret e zonës pasi ka një largësi të konsiderueshme nga qendrat e banuara.



Mbetjet e prodhuara

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk pritet te gjenerohet mbetje. Persa i perket mbetjeve urbane te gjeneruara nga punojesit ato do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga administratori per ti derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Masat per shkarkimet ne uje

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk do te gjenerohet uje pasi nuk do te kete perdorim te ujit ne aktivitet, gjithashtu nuk do te kete shkarkime ne kanalizime pasi nuk do te kete gjenerim te ujrave sanitare.

Masat per emetimet ne ajer

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te kemi emetime te lehta ne ajer ne mjediset e jashtme. Ky emetim do te vije si pasoj e clirimit te gazeve dhe te grimcave te pluhurit nga levizja e automejteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare. Ne mjediset e brendshme do te kete prezence te paket aromash, i cili do te jete i perhershem per sa kohe eshte aktiviteti ne funksionim.

Subjekti do te kujdeset qe te gjitha automjetet qe bejne te mundur transportin e lendes se pare te jene te kolauduara dhe ne gjende te mire pune. Gjithashtu per uljen e perqendrimit te grimcave te pluhurit, subjekti ne periudhe te thate do te realizoje sperkatjen e ambjenteve te jashtme me uje.

Ne mjediset e brendshme do te kete prezence te paket aromash, i cili do te jete i perhershem per sa kohe eshte aktiviteti ne funksionim. Do te realizohet pastrimi periodik i mjedisit dhe seres per largimin e aromes.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat dhe vibrimet do te jene prezent vetem gjate levizjes se automjeteve te automejteve te transportit te lendeve te para. Keto emetime nuk perbejne bezdi te banoret e zones pasi ka nje largesi te konsiderueshme nga qendrat te banuara.

Per te ulur ne sasi te larte prezencen e zhurmave dhe vibrimeve ne mjediset e jashtme, do te tregohet nje kujdes i vecant per te shkurtuar oraret e prezences se automjeteve te transportit te lendes se pare ne subjekt si dhe levizja e ketyre automjeteve te jete me shpejtesi te ulet.



Mbetjet e prodhuara

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk pritet te gjenerohet mbetje. Persa i perket mbetjeve urbane te gjeneruara nga punojesit ato do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga administratori per ti derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit jane shume te rendesishme. Ato jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:

- Largimin e materialeve te ndezshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
- Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
- Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
- Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces.
- Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuaresive si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidratante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem

Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.



Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

Detyrimet e punëdhënësit

Per te shmangur aksidentet ne pune, punëdhënësi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.